



PJESA I E KONTRATËS: KONTRATA PUBLIKE KORNIZË

Komuna e Prishtinës (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë;

dhe

**"N.T.SH. " MEDILAB-HUMAN ", Bregu i Diellit , Lam 4/3, 10000,
Prishtinë, Kosovë**, ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike kornize përfurnizim me:

Furnizim me material shpenzues laboratorik dhe mjekësor-LLOT II

Nr1 i prokurimit	616-20-1229-1-1-1
Nr i brendshëm	616 20 016 111

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontrate publike kornizë është të krijoj kushtet, duke përfshirë çmimet dhe rregullat e implementimit për dorëzimin e mallrave në vijim: **Furnizim me reagjenta per biokimi**

Autoriteti Kontraktues bënë blerjen vetëm në emër të vetë Autoritetit

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me “vendosjen e porosive” apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë “porosinë” tek furnizuesi, duke specifikuar listën me artikuj përfurnizim me sasitë e tyre përkatëse.

1.3 Sositë e vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative. Autoriteti(et) Kontraktues i përmendor në Nenin¹.1.1 është (janë) i/të detyruar të përdorë/in këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë mallératë përmendura në 1.1..

1.4 Kontrata hynë në fuqi me daten e nenshkrimit me afat prej 12 muajve.

Neni 2 Kushtet e dërgesës

2.1 Afati kohor përdorëzim do të jetë 20 ditë nga koha e pranimit te urdherit nga personi I autorizuar nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jetë Prishtine.

2.3 Inkotermi I zbatueshëm do të jetë DDP² (Dërgesat e Detyrës të Paguara).

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

¹⁷ DDP – Dërgesat e Detyrës të Paguara –Incoterms 2010 Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë.

Neni 3 Origjina

3.1 Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërpërjen e kontratës

3.2 Origjina e mallrave do të përcaktohet sipas Kodit të Doganave të Bashkësisë Evropiane (Community Customs Code-) ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar vendi në fjalë.

Neni 4 Çmimi

4.1 Çmimet njësi të furnizimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Furnizuesi.

Vlera totale indikative e kontratës është [16 808,00] Euro. Derivimi i lejuar nga vlera totale indikative është +/- 30%. Nëse urdhër blerjet tejkalojnë sasinë totale indikative ose vlerën totale indikative të kontratës publike kornizë (duke përfshirë + tridhjetë përqind (30%), pa marrë parasysh datën origjinale të skadimit të Kontratës Publike Kornizë, kontrata do të ndërpitet automatikisht. Mospërputhja e lejuar plus/minus tridhjetë përqind (30%) vlen edhe pér pozicion/artikull, dhe ne rast te arritjes se pragut te lejuar AK nuk mund te beje porosi tjera pér atë pozicion/artikull.

4.2 Çmimi i përmendur në Nenin 4.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Furnizuesit sipas kontratës publike kornizë.

4.3 Çmimet per njësi janë fikse dhe nuk do ti nënshtrohen ndryshimeve pér porositë e vendosura nën këtë kontratë kornizë

4.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

Neni 5 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 6 Komunikimet

6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit pér pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme pér të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

6.3 Kudo qe në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përvçe nëse specifikohet ndryshtësë njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar


dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë "do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsy.

6.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhet shqipe³ in në tri origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Furnizuesin.

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Zeke Bardhaj
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	07.07.2020
Vula:	

Për Furnizuesin

Emri:	DRIN RAMADANI
Pozita:	MENAXHER
Nënshkrimi:	
Data:	07.07.2020
Vula:	

18 Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga ana e tenderuesit në këtë tender.

PJESA II E KONTRATËS KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimet

1.1 "Kontratë" do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Furnizuesit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 "Produktet" përkufizohen si të mira materiale që kanë vlerë ekonomike, duke përfshirë por pa u kufizuar në mallrat, artikujt, lëndët e para, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë të lëngshme ose të gazshme.

1.3 "Autoriteti Kontraktues" do të thotë organizata e blerjes së mallrave, siç është e quajtur Fletën mbi të Dhënat e Tenderit.

1.4 "Furnizues" do të thotë një person fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon mallra që janë objekt i kësaj kontrate.

1.5 "Palë(t)" do të thotë nënshkruesit e kontratës.

1.6 "Inkotermet" do të thotë termat ndërkontaktojnjë mënyrën, kostot dhe rreziqet që lidhen me transferimin e produkteve nga furnizuesi tek autoriteti kontraktues.

1.7 "Furnizim" do të thotë dorëzim i produkteve me cilësi, sasi dhe lloj të specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.

1.8 "Çmimi i kontratës" do të thotë çmimi që i paguhet furnizuesit siç specifikohet në formularin e kontratës, në përputhje me shtesa të tilla dhe rregullimet ose heqjet, si mund të bëhet në bazë të kontratës.

1.9 "Shërbimet pas shitjes" do të thotë shërbimet ndihmëse, si: instalimi, mirëmbajtja, riparimi i furnizimeve, sigurimi i pjesëve rezervë që i prodhon apo i distribuo furnizuesi dhe/ose detyrime të ngashme në lidhje me furnizimet e produkteve.

1.10 "KPK" do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.11 "KVK" do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Furnizuesi e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Furnizuesi nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përvèç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Furnizuesit, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Furnizuesit siguruesve të Furnizuesit për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Furnizuesit.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lironë Furnizuesin nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përvèç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Furnizuesi ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit te ofertes. Ne rast te ndryshimit te nënkontraktuesve gjate implementimit te kontrates, Furnizuesi duhet te njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Furnizuesin për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Furnizuesi nuk nënkontraktion pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithe nënkontraktuesit e propozuar duhet te përmblushin kërkuesat e pershtatshmerise.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontrakte ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Furnizuesi është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Furnizuesit, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Furnizuesin nga obligimet e tij sipas kontratës.

4.5 Nëse nënkontraktuesi ka marrë ndonjë obligim të vazhdueshëm që vazhdon për një periudhë që e tejkalon atë të periudhës së garancisë nën kontratë ndaj Furnizuesit, përkthitazi me furnizimet që i jep nënkontraktuesi. Furnizuesi duhet që, në çfarëdo momenti pas skadimit të periudhës së garancisë, i transferojë menjëherë te Autoriteti kontraktues, me kërkesë dhe shpenzime të Autoritetit kontraktues, përsitimet e obligimeve të tilla për kohëzgjatjen e garancisë së skaduar.

Neni 5 Dhënia e dokumenteve

5.1 Nëse është e nevojshme, brenda 30 ditësh nga nënshkrimi i kontratës, autoriteti kontraktues duhet t'i japë Furnizuesit pa pagesë atëherë kur është e nevojshme, një kopje të skicave të përgatitura për realizimin e kontratës dhe kopje të specifikimeve dhe dokumenteve tjera të kontratës. Furnizuesi mund të blejë kopje tjera të këtyre skicave, specifikimeve dhe dokumenteve tjera, në rast se ato mund të gjenden. Pas lëshimit të certifikatës së garancisë, ose pas pranimit final të saj, Furnizuesi i kthen autoritetit kontraktues të gjitha skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera të kontratës.

5.2 Përveç nëse është e nevojshme për qëllime të kontratës, skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera që i jep autoriteti kontraktues nuk duhet të përdoren as nuk duhet t'i komunikohen një pale të tretë nga Furnizuesi pa pajtim paraprak të autoritetit kontraktues.

5.3 Autoriteti kontraktues ka autoritetin për t'i lëshuar Furnizuesit urdhra administrative që inkorporojnë ato dokumente plotësuese dhe udhëzimet që janë të nevojshme për ekzekutim të mirë të kontratës dhe për kompensim dëmi nga ndonjë defekt të saj.

Neni 6 Ndihma lidhur me rregulloret vendore

6.1 Furnizuesi mund të kërkojë ndihmën e Autoritetit kontraktues për marrjen e kopjeve të ligjeve, rregulloreve dhe informatave mbi zakonet, urdhërët apo ligjet anësore të Republikës se Kosovës të cilat mund të ndikojnë te furnizuesi gjatë realizimit të obligimeve të tij me kontratë. Autoriteti kontraktues mund ta japë ndihmën e kërkuar nga Furnizuesi me shpenzime të Furnizuesit.

6.2 Nëse është e nevojshme, Furnizuesi do ta lajmërojë me kohë Autoritetin kontraktues për të dhënë mbi furnizimet ashtu që Autoriteti kontraktues të mund të marrë lejet e këruara ose licencat e importit.

6.3 Autoriteti kontraktues do të vendlosë që të marrë lejet e këruara apo licencat e importit brenda një periudhe të arsyeshme, duke marrë parasysh datat e realizimit të kontratës.

Neni 7 Obligimet e përgjithshme të Furnizuesit

7.1 Furnizuesi duhet ta realizojë kontratën me kujdesin dhe syçeltësinë e duhur duke përfshirë, aty ku është specifikuar, dizajnin, prodhimin, dorëzimin e furnizimit dhe kryerjen e punëve të tjera përfshirë kompensimin për ndonjë defekt në furnizime.

7.2 Furnizuesi duhet të veprojë sipas urdhreve administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Furnizuesi konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtëj fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu eksposuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

7.3 Furnizuesi duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmët e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

7.4 Furnizuesi duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai, duke iu shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

7.5 Nëse Furnizuesi është grup, përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlgimin paraprak me shkrim të Autoritetit kontraktues.

Neni 8 Siguria e ekzekutimit

8.1 Furnizuesi do t'ë, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mire të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Furnizuesit.

8.2 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

8.3 Përveç asaj pjese të specifikuar në KVK lidhur me shërbimin pas-shitjes, siguria e ekzekutimit do të lëshohet brenda 30 ditësh nga lëshimi i certifikatës se perkoħshme të pranimit.

Neni 9 Sigurimi

9.1 Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet te jene te siguruara plotësisht me një valute lirisht te konvertueshme kundër humbjes ose dëmtimit te rastësishëm te prodhoj ose blejë, transportoj, ruaj dhe shpërndaj ne mënyrën e specifikuar ne KVK.

9.2 Pa marrë parasysh obligimet e sigurimit të Furnizuesit sipas Nenit 9.1, Furnizuesi do të mbajë përgjegjësi të plotë, dhe do ta sigurojë Autoritetin kontraktues nga të gjitha ankesat nga palët e treta për dëm ndaj pronës ose lëndime personale që shkaktohen nga ekzekutimi i kontratës nga ana e Furnizuesit, nënkontraktuesve dhe punëtorëve të tyre.

Neni 10 Tatimi

10.1 Furnizuesi është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përpunje me Ligjin e Republikës se Kosovës.

10.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

10.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të pranimit te mallrave.

10.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes se detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë Furnizuesi.

Neni 11 Patentat dhe licencat

11.1 Furnizuesi do ta sigurojë autoritetin kontraktues nga të gjitha ankesat që janë rezultat i përdorimit të patentave, licencave, skicave, modeleve ose markave apo emrave tregtarë siç është specifikuar në kontratë, përvèç nëse shkelja e tillë është rezultat i veprimit sipas dizajnit ose specifikimit të dhënë nga autoriteti kontraktues.

Neni 12 Periudha e ekzekutimit të detyrave

12.1 Periudha e ekzekutimit të detyrave do të fillojë në datën e lëshimit të Urdhër Blerjes, pa paragjykim ndaj zgjatjeve të periudhës të cilat mund të lejohen sipas Nenit 13.

Neni 13 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

13.1 Furnizues mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsyë:

- Autoriteti kontraktues porosit furnizime ekstra ose plotësuese;
- Kushte të jashtëzakonshme klimatike në vendin e autoritetit kontraktues kanë prekur instalimin apo dorëzimin e furnizimeve;
- Pengesa apo kushte fizike që mund të ndikojnë në dorëzimin e furnizimeve, të cilat nuk kanë mundur të parashihen në mënyrë të mjaftueshme nga një furnizues kompetent;
- Urdhra administrative që kanë ndikuar në datën e realizimit, përvèç atyre që janë shkaktuar prej gabimit të furnizuesit;
- Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- Të gjitha suspendimet e dorëzimit dhe/ose instalimit të furnizimeve që nuk janë për shkak të gabimit të Furnizuesit;
- Forca madhore;
- Shkaqe tjera që janë përmendur në këto Kushte të përgjithshme dhe të cilat nuk janë për shkak të gabimit të Furnizuesit.

13.2 Brenda 15 ditësh pasi ka kuptuar se mund të ketë vonesë, Furnizues duhet ta lajmërojë autoritetin kontraktues se ka për qëllim të bëjë kërkesë për zgjatje të periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përvèç nëse ka ndonjë marrëveshje tjetër ndërmjet Furnizuesit dhe autoritetit kontraktues, brenda 30 ditësh i jep autoritetit kontraktues të dhëna gjithëpërfshirëse ashtu që të mund të kontrollohet kërkesa.

13.3 Brenda 30 ditësh, me njoftim me shkrim për furnizuesin, autoriteti kontraktues do ta lejojë këtë zgjatje të periudhës së realizimit nëse mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive ose retrospektive, ose ta informojë Furnizuesin që nuk i është dhënë e drejta për zgjatje të periudhës.

Neni 14 Vonesat e ekzekutimit

14.1 Nëse Furnizues me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat ose të realizojë shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale

të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuar deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosise. Autoriteti Kontraktues mund të zgresë dëmet e likuiduara nga pagesat te cilat duhet ti behen Furnizuesit. Pagesat e dëmeve të likuiduara nuk do të prekin detyrimet e furnizuesit.

14.2 Nëse mosdorëzimi i mallrave parandalon përdorimin e zakonshëm të furnizimeve në tërësi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 14.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të porosise.

14.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së porosise ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Furnizuesin:

a. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me nje operatore ekonomik:*

- te konfiskojë garancinë e realizimit;
- te ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Furnizuesi nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
- të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhënien e pjesës së mbetur të furnizimeve. Furnizuesi nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Furnizuesi gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.

b. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me disa operatore ekonomik:*

- te konfiskojë garancinë e realizimit;
- te ndërpresë porosine, dhe në këtë rast Furnizuesi nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Furnizuesi gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

c. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoriteteteve tjera Kontraktuese, me nje operatore ekonomik:*

- Autoriteti Kontraktues i cili ka bere porposine anulon porosine dhe ritenderon, dhe në këtë rast Furnizuesi nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Furnizuesi gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kérkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% të porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues.

a. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoriteteteve tjera Kontraktuese, me disa operatore ekonomik:*

- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kérkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% të porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues;
- te ndërpresë porosine, dhe në këtë rast Furnizuesi nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Furnizuesi gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

Neni 15 Suspendimi

15.1 Autoriteti kontraktues mundet, me urdhër administrativ, në çfarëdo kohe ta udhëzojë Furnizuesin që të pezullojë:

- a. prodhimin e furnizimeve;
- b. dorëzimin e furnizimeve në vendin e pranimit në kohën e specifikuar për dorëzim; ose
- c. instalimin e furnizimeve që janë dorëzuar në vendin e pranimit.

15.2 Gjatë pezullimit, Furnizuesi do të mbrojnë dhe sigurojnë furnizimet e vendosura në depon e Furnizuesit ose në ndonjë vend tjeter, nga përkeqësimi, humbja apo dëmtimi për aq sa të jetë e mundur dhe sa është kërkuar nga autoriteti kontraktues, edhe nëse furnizimet janë dorëzuar në vendin e pranimit në pajtim me kontratën, por instalimi i tyre është pezulluar nga autoriteti kontraktues.

15.3 Shpenzimet plotësuese që janë shfaqur në lidhje me këto masa mbrojtëse do t'i shtohen çmimit të kontratës. Furnizuesi nuk do të marrë pagesë të shpenzimeve plotësuese nëse pezullimi është:

- a) Zgjidhur në mënyrë të ndryshme në kontratë; ose
- b) është i nevojshëm pér arsyë të kushteve të zakonshme klimatike në vendin e pranimit;
- c) është i nevojshëm pér shkak të ndonjë gabimi të Furnizuesit; ose
- d) është i nevojshëm pér siguri të ekzekutimit të mirë të kontratës ose të ndonjë pjese të saj pérderisa nevoja e tillë nuk shkaktohet nga ndonjë veprim apo gabim nga autoriteti kontraktues.

15.4 Furnizues nuk do të ketë të drejtë pér shtesa në çmimin e kontratës pérveç nëse ai e lajmëron autoritetin kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit pér të pezulluar progresin e dorëzimit se ka pér qëllim të bëjë ankesë pér ta.

15.5 Autoriteti kontraktues, pas konsultimit me Furnizuesin, do të përcaktojë ato pagesa plotësuese dhe/ose zgjatje të periudhës së realizimit që do të bëhen nga Furnizues përkizazi me këtë ankesë në mënyrë të drejtë dhe të arsyeshme sipas mendimit të autoritetit kontraktues.

15.6 Nëse periudha e pezullimit i tejkalon 180 ditë, dhe pezullimi nuk është pér shkak të gabimit të Furnizuesit, Furnizues, duke njoftuar autoritetin kontraktues, mund të kërkojë të vazhdojë me furnizimet brenda 30 ditësh, ose të ndërpresë kontratën.

15.7 Në rastet kur procedura e dhënes ose realizimit të kontratës bëhet e pavlefshme pér shkak të gabimeve përbajtjesore, parregullsive ose mashtrimit, Autoriteti kontraktues do ta pezullojë realizimin e kontratës. Në rastet kur ato gabime, parregullsive ose mashtrime i atribuohen Furnizuesit, atëherë Autoriteti kontraktues mund të refuzojë t'i bëjë pagesat ose mund t'i kthejë shumat që tashmë janë paguar, në proporcione rëndësinë e gabimeve, parregullsive ose mashtrimit.

15.8 Qëllimi i pezullimit të kontratës është që të verifikohet nëse gabimet përbajtjesore të supozuara si dhe parregullsitë apo mashtrimet kanë ndodhur në të vërtetë. Nëse ato nuk mund të konfirmohen, realizimi i kontratës do të rifillojë sa më shpejt që është e mundur. Gabimet përbajtjesore ose parregullsitë do të janë të gjitha shkelje të kontratës ose dispozitive rregullative që rezultojnë nga një veprim ose mosveprim që shkakton ose që mund të shkaktojë humbje në buxhetin e Autoritetit Kontraktues.

Neni 16 Cilësia e furnizimeve

16.1 Furnizimet duhet t'i plotësojnë specifikimet teknike të paraqitura në kontratë në të gjitha aspektet dhe të janë konform në të gjitha aspektet me skicat, sondazhet, modelet, mostrat, strukturat dhe kërkesat tjera në kontratë, të cilat duhet të mbahen në dispozicion të Autoritetit kontraktues pér qëllime identifikimi gjatë periudhës së realizimit të kontratës.

16.2 Të gjitha pranimet teknike preliminare të parapara në KVK duhet të bëhen me kërkesë të dërguar nga furnizuesi pér autoritetin kontraktues. Në kërkesë do të saktësohen materialet, artikujt dhe mostrat e dorëzuar pér këtë pranim sipas kontratës dhe të tregojë numrin e sasisë dhe vendin ku do të bëhet pranimi në mënyrën e ndihmës. Materialet, artikujt dhe mostrat e specifikuara në kërkesë duhet t'i certifikohen nga autoriteti kontraktues se plotësojnë kërkesat pér këtë pranim para se të inkorporohen në furnizime.

16.3 Edhe nëse materialet apo artikujt që do të inkorporohen në furnizime ose në prodhim të komponentëve që do të furnizohen janë pranuar teknikisht në këtë mënyrë, ato prapë mund të refuzohen nëse ndonjë kontrollim tjetër zbulon defekte ose gabime, dhe në këtë rast ato duhet t'i ndërrohen menjëherë nga furnizuesi. Furnizuesit mund t'i jepet mundësia t'i riparojë dhe t'i përmirësojë materialet dhe artikujt që janë refuzuar, por këto materiale dhe artikujt do të pranojen pér inkorporim në furnizime vetëm nëse janë riparuar dhe janë përmirësuar në atë mënyrë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

Neni 17 Inspektimi dhe testimi

17.1 Furnizues do të sigurojë që furnizimet të dorëzohen në vendin e pranimit me kohë që t'i mundësohet autoritetit kontraktues të vazhdojë me pranimin e furnizimeve. Furnizuesi konsiderohet se i ka paraparë plotësisht vështirësitet që mund t'i hasë në këtë aspekt, dhe atij nuk do t'i lejohet që të paraqesë ndonjë arsyë pér vonesë.

17.2 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet pér t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar. Kjo do të bëhet në vendin e prodhimit, fabrikimit, përgatitjes ose në vendin e pranimit apo në vendet që janë specifikuar në KVK.

17.3 Pér qëllime të testimeve dhe inspektiveve të tilla, Furnizues do t'ë:

- a) I japë autoritetit kontraktues, përkohësisht dhe pa pagesë, ndihmë, mostra ose pjesë pér testim, makina, pajisje, vegla, punë, materiale, skica dhe të dhëna të prodhimit që zakonisht kërkohen pér inspektim dhe testim;
- b) Të merret vesh me autoritetin kontraktues pér vendin dhe kohën e testimeve;
- c) T'i japë autoritetit kontraktues qasje në çfarëdo kohe të arsyeshme në vendin ku do të realizohen testimet.

17.4 Nëse përfaqësuesi i Autoriteti Kontraktues nuk është prezent në datën e vendosur pér testim, furnizuesi mundet që, përvëç nëse ka marrë udhëzim tjetër nga autoriteti kontraktues, të vazhdojë testimin, i cili do të konsiderohet se është bërë në prezencën e autoritetit kontraktues. Furnizuesi menjëherë do t'i dërgojë kopjet e certifikuarë si duhet të rezultateve të testit te Autoriteti

kontraktues, nëse nuk ka qenë prezent gjatë testit, do t'i pranojë rezultatet e testit.

17.5 Nëse komponentët dhe materialet i kanë kaluar testet e sipërpermendura, autoriteti kontraktues do ta lajmërojë furnizuesin ose ta miratojë certifikimin e furnizuesit lidhur me këtë.

17.6 Nëse autoriteti kontraktues dhe Furnizues nuk pajtohen për rezultatet e testit, secili do t'ia japë tjetrit mendimin e vet brenda 15 ditësh nga mospajtimi i tillë. Autoriteti kontraktues ose Furnizues mund të kërkojnë që këto teste të përsëriten në të njëjtat kushte dhe rrethana, ose nëse ndonjëra palë kérkon, të testohen nga një ekspert i zgjedhur me marrëveshje të ndërsjellë. Të gjitha raportet e testimit do t'i dorëzohen autoritetit kontraktues, i cili do t'i komunikojë rezultatet e këtyre testeve pa vonesë te furnizuesi. Rezultatet e ri-testimit do tëjenë përfundimtare. Kostoja e ri-testimit do të bartet nga pala pikëpamja e së cilës dëshmohet se është gabim pas ri-testimit.

17.7 Gjatë realizimit të detyrate të tyre, autoriteti kontraktues dhe personat e autorizuar nga ai nuk do t'i shpalosin personave të paautorizuar informata lidhur me metodat e ndërmarrjes së prodhimit dhe operimit, të cilat informata i kanë marrë gjatë inspektimit dhe testimit.

Neni 18 Parimet të përgjithshme të pagesave

18.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Pagesat qe duhet te bëhen sipas faturës se lëshuar nga Furnizues do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Furnizuesi. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

18.2 Shumat duhet të paguhën brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

18.3 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar Furnizuesin që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përbajtjesore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëherëshëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Furnizues do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

18.4 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 18.2, Furnizues mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga institucioni lëshues i Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

18.5 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 18.2 do t'i jepin të drejtë Furnizuesit që ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

18.6 Në rast se Autoriteti Kontraktues është duke blerë në emër të Autoriteteve tjera Kontraktuese, dhe nëse një autoritet kontraktues nuk plotëson obligimet e tij sipas kësaj kontrate sidomos obligimet e Nenit 18.2 furnizuesi mund të informojë AQP-në për shkelje të tillë. AQP mund të ndalojë autoritetin kontraktues nga përdorimi i ndonjë dhe i të gjitha kontratave të përbashkëta kornizë të konkluduara nga AQP.

Neni 19 Dorëzimi

19.1 Furnizuesi duhet t'i dorëzojë furnizimet në pajtim me kushtet e kontratës. Furnizimet do tëjenë në përgjegjësi të Furnizuesit deri në pranimin e tyre të përkohshëm.

19.2 Furnizuesi do t'i paketojë furnizimet ashtu siç kërkohet për të parandaluar dëmtimin apo keqësimin e gjendjes së tyre gjatë transportit deri në destinacionin e tyre, siç është dhënë në kontratë. Paketimi duhet të jetë i mjaftueshëm për të përballuar pa kufizime, bartjen e ashpër, eksposimini në temperaturë ekstreme, kripën dhe rëniet gjatë tranzitit dhe mbajtjen në ambient të hapur. Madhësia e paketimit dhe pesha duhet t'i përshtaten, nëse është e mundur, largësisë së destinacionit përfundimtar të furnizimeve, dhe mundësisë së mungesës së pajisjeve përbartje të rëndë në të gjitha pikat gjatë transitit.

19.3 Paketimi, shënim i dokumentacioni brenda dhe jashtë pakove duhet tëjenë në pajtim me kërkesat e dhëna në mënyrë të hapur në KVKG, dhe i nënshtronë ndryshimeve që mund të urdhërohen më vonë nga autoriteti kontraktues.

19.4 Asnjë furnizim nuk do të transportohet as të dorëzohet në vendin e pranimit derisa furnizuesi të ketë pranuar urdhrrin e

dorëzimit nga autoriteti kontraktues. Furnizuesi do të jetë përgjegjës për dorëzim në vendin e pranimit të të gjitha furnizimeve dhe pajisjeve të furnizuesit, që janë të nevojshme për qëllime të kontratës.

19.5 Dorëzimi duhet të konsiderohet se është bërë atëherë kur ka dëshmi me shkrim që është në dispozicion për të dy palët se dorëzimi i furnizimeve është bërë në pajtim me kushtet e kontratës.

Neni 20 Operacionet e verifikimit

20.1 Furnizimet nuk do të pranohen derisa të janë realizuar verifikimet dhe testet e caktuara me shpenzime të Furnizuesit. Inspektimet dhe testet mund të realizohen para transportit, në pikën e dorëzimit dhe/ose në destinimin final të mallrave.

20.2 Autoriteti kontraktues, gjatë progresit të dorëzimit të furnizimeve dhe para se të merren furnizimet, duhet të ketë fuqinë që të urdhërojë ose të vendosë:

- heqjen nga vendi i pranimit, brenda asaj kohe ose kohësh siç është specifikuar në urdhër, të të gjitha furnizimeve të cilat, sipas mendimit të autoritetit kontraktues, nuk janë në pajtim me kontratën;
- zëvendësimin e tyre me furnizime të mira dhe të përshtatshme;
- heqjen dhe ri-instalimin e mirë të pajisjeve, pa marrë parasysh testet e mëparshme të tyre ose pagesat e pjesshme të tyre, ose ndonjë instalim që lidhet me materialet, mjeshtërinë ose dizajnin për të cilin është përgjegjës furnizuesi, e që sipas mendimit të autoritetit kontraktues nuk është në pajtim me kontratën;
- që puna e bërë ose mallrat e dorëzuara apo materialet e përdorura nga furnizuesi janë ose nuk janë në pajtim me kontratën, ose që furnizimet apo një pjesë e tyre nuk i plotësojnë kërkesat e kontratës.

20.3 Furnizuesi, sa më shpejt që është e mundur dhe me shpenzime të veta, duhet t'i evitojë defektet e specifikuara. Nëse Furnizuesi nuk vepron sipas këtyre urdhrove, Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të punësojë persona tjera për t'i zbatuar urdhrat dhe të gjitha shpenzimet që janë pasojë e kësaj, apo që do të shfaqen për shkak të kësaj. Autoriteti kontraktues do t'i zblesë nga paratë që do të paguhen ose të cilat do të bëhen obligim për t'u paguar Furnizuesit.

20.4 Furnizimet që nuk janë të cilësisë së kërkuar do të refuzohen. Një shenjë speciale mund t'u vendoset furnizimeve të refuzuara. Shenza nuk duhet të jetë e atillë që t'i ndryshojë ato, apo t'i ndikojë në vlerën e tyre komerciale. Furnizimet e refuzuara furnizuesi do t'i heqë nga vendi i pranimit, nëse këtë e kérkon autoriteti kontraktues, brenda një periudhe që e saktëson autoritetit kontraktues, dhe nëse kjo nuk realizohet ato do të hiqen me të drejtë me shpenzim dhe me rrezik të furnizuesit. Të gjitha punët që përfshijnë materialet e refuzuara do të refuzohen.

Neni 21 Pranimi i përkohshëm

21.1 Furnizimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të janë dorëzuar në pajtim me kontratën, t'i kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet e kërkua, dhe të janë autorizuar, si dhe të jetë lëshuar një certifikatë e pranimit të përkohshëm ose nëse konsiderohet se është lëshuar.

21.2 Furnizuesi mund të bëjë kërkesë, duke lajmëruar autoritetin kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm atëherë kur furnizimet të janë të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga pranimi i aplikacionit të furnizuesit do të veprojë sipas njërsë nga këto më poshtë:

- t'i lëshojë furnizuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përvèç tjersh, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar furnizimet në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij e kérkon Furnizuesi për ta lëshuar certifikatën.

21.3 Nëse rrethanat e jashtëzakonshme e bëjnë të pamundur që të vazhdohet me pranimin e furnizimeve gjatë periudhës së fiksuar për pranim të përkohshëm ose final, autoriteti kontraktues e përgatit një deklaratë për ta vërtetuar pamundësinë e tillë, nëse është e mundur, në konsultim me furnizuesin. Certifikata e pranimit ose e refuzimit do të përgatitet brenda 30 ditësh pas datës në të cilën kjo pamundësi pushon së ekzistuar. Furnizuesi nuk do të nxisë shfaqjen e këtyre rrethanave për të evitar obligimin e paraqitjes së furnizimeve në një gjendje të përshtatshme për pranim.

21.4 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej [30] ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe, përvèç në rastet kur certifikata e pranimit të përkohshëm konsiderohet se përbën certifikatë të pranimit përfundimtar. Nëse furnizimet ndahen me kontratë në pjesë, Furnizuesi do të ketë të drejtë të bëjë kërkesë për certifikatë të veçantë për secilën pjesë.

21.5 Në raste të dorëzimit të pjesshëm, Autoriteti kontraktues rezervon të drejtën për të dhënë pranim të pjesshëm e të përkohshëm.

21.6 Pas pranimit të përkohshëm të furnizimeve, Furnizuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kérkohen më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kérkohen në kontratë.

Neni 22 Obligimet për garanci

22.1 Furnizuesi do të garantojë që furnizimet të jenë të reja, të papërdorura, të modeleve të fundit dhe të përfshijë të gjitha përmirësimet e kohëve të fundit në dizajn dhe materiale, përvç nëse kërkohet ndryshe në kontratë. Furnizuesi do të garantojë që asnje nga furnizimet të mos kenë defekt që shkaktohet nga dizajni, materialet apo mjeshtëria. Kjo garanci do të mbetet e vlefshme në atë mënyrë që saktësohet në KVK.

22.2 Furnizuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve në ndonjë pjesë të furnizimeve të cilat mund të paraqiten, apo të ndodhin gjatë periudhës së garancisë dhe të cilat:

- rezultojnë nga përdorimi i materialeve defektive, mjeshtërisë së gabueshme ose dizajnit jo të mirë nga Furnizuesi; ose
- rezultojnë nga veprimet ose mosveprimet e Furnizuesit gjatë periudhës së garancisë; ose
- shfaqen gjatë ndonjë inspektni të bërë nga Autoriteti kontraktues ose në emër të tij.

22.3 Furnizuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt që kjo të mund të praktikohet. Periudha e garancisë për të gjithë artikujt e ndërruar ose të riparuar do të fillojë përsëri nga data në të cilën është bërë ndërrimi ose riparimi sipas vlerësimit të autoritetit kontraktues. Periudha e garancisë do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të furnizimeve që është ndikuar nga ndërrimi apo riparimi.

22.4 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së garancisë, autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Furnizuesin. Nëse Furnizuesi nuk arrin ta kompensojë dëmin nga ndonjë defekt ose një dëm brenda afatit kohor të paraparë në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- të korrigojë defektin apo dëmin vetë, ose të punësojë dikë tjetër për ta bërë punën në rrezikun dhe me shpenzimet e Furnizuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga paratë që duhet të paguhen ose garancitë që mbahen prej Furnizuesit ose nga të dy;
- në rast se nuk ka sasi të duhur ose asnje garanci nuk është efektive kërkoni që të merrni shumën e duhur nga Furnizuesi; ose
- të ndërpresë kontratën.

22.5 Obligimet e mirëmbajtjes do të parashihen në KVK dhe në specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së garancisë nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e garancisë do të fillojë në datën e pranimit të përkohshëm.

Neni 23 Shërbimet pas-shitjes

23.1 Shërbimet pas-shitjes, nëse kërkohen në kontratë, do të jepen në pajtim me të dhënat e parapara në KVK. Furnizuesi do të marrë përsipër të realizojë ose të organizojë realizimin e mirëmbajtjes dhe të riparimit të furnizimeve dhe të sigurojë shpejt pjesët rezervë. KVK mund të saktësojnë që Furnizuesi të sigurojë ndonjë ose të gjitha materialet e mëposhtme, njoftimet dhe dokumentet që kanë të bëjnë me pjesët rezervë që i prodhon apo i distribuon Furnizuesi:

- pjesët rezervë të cilat Autoriteti kontraktues mund të vendosë t'i blejë nga Furnizuesi, duke kuptuar që ky vendim nuk do ta lirojë Furnizuesin nga obligimet e garancisë sipas kontratës
- në rast të ndërprerjes së prodhimit të pjesëve rezervë, duhet të lajmërohet paraprakisht Autoriteti kontraktues për t'i mundësuar që të blejë pjesët e kërkua dhe, pas ndërprerjes, skicat, vizatimet dhe specifikimet e pjesëve rezervë, nëse kërkohen dhe kur kërkohen do t'i sigurohen Autoriteti kontraktues pa pagesë.

Neni 24 Pranimi përfundimtar

24.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojet Furnizuesit një certifikatë të pranimit përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Furnizuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata finale e pranimit do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 22 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

24.2 Kontrata nuk do të konsiderohet se është realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit ose derisa të konsiderohet se kjo është nënshkruar nga autoriteti kontraktues.

24.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Furnizuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë mbetur të parealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve të tillë do të përcaktohen duke iu referuar dispozitatë të kontratës.

Neni 25 Shkelja e kontratës

- 25.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.
- 25.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:
- a) dëmet; dhe/ose
 - b) ndërprerjen e kontratës.
- 25.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpérblime. Ato mund të janë:
- a) dëme të përgjithshme; ose
 - b) dëme të likuidueshme.

25.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Furnizuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

Neni 26 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

26.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Furnizuesit 7 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- a) kur Furnizuesi në mënyrë përbajtjesore nuk arrin t'i realizojë obligimet e veta sipas kësaj kontrate;
- b) Furnizuesi dështon në përbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim përfunduar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të punëve;
- c) Furnizuesi refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhreve administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;
- d) Furnizuesi ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
- e) Furnizuesi falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kreditusit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtronhet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nationale;
- f) Furnizuesi është dënuar përfunduar obligimet e veta sipas kontratës;
- g) Furnizuesi është shpallur fajtor përfunduar obligimet e veta sipas kontratës;
- h) Furnizuesi i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e res judicata përfunduar obligimet e veta sipas kontratës;
- i) Furnizuesi, pas një procedure tjetër të prokurimit ose procedure të dhënies së një granti të financuar nga buxheti i komunitetit, është deklaruar se ka bërë shkelje serioze të kontratës përfunduar obligimet e veta sipas kontratës;
- j) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Furnizuesit, përvëç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;
- k) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimin e kontratës;
- l) Furnizuesi nuk arrin t'i japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që i jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

26.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Furnizuesit sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Furnizuesit. Detyrimi i Furnizuesit përfunduar obligimet e veta sipas kontratës, përfunduar furnizimet e dorëzuara dhe punës së realizuar dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;

26.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njofimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Furnizuesin që të ndërmarrë hapa të menjëherë përfunduar obligimet e veta sipas kontratës, do të përfunduar furnizimet e dorëzuara dhe punës së realizuar dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;

26.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Furnizuesit ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi furnizimet e dorëzuara dhe punës së realizuar dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;

26.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera përfunduar furnizimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Furnizuesi koston ekstra, nëse ka, të furnizimeve ose do të paguajë

shumën që duhet t'i paguhet Furnizuesit para ndërprerjes së kontratës.

26.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Furnizuesi humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës të parapara në Nenin 2 të KVK.

Neni 27 Ndërprerja nga ana e Furnizuesit

27.1 Furnizuesi, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 7 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues:

- nuk arrin t'i paguajë Furnizuesit shumat që duhet të paguhen në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit.
- vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose
- e pezullon dorëzimin e furnizimeve, ose ndonjë pjesë të tyre, për më tepër se 180 ditë, për arsy që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk mund t'i atribuohen Furnizuesit.

27.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Furnizuesit.

27.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) te Seksionit 27.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Furnizuesin për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Furnizuesit.

Neni 28 Forca madhore

28.1 Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë mosrespektim ose shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tillë parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një *forcë madhore* që shkaktohet pas datës kur kontrata hyjnë fuqi.

28.2 Për qëllime të këtij Neni, termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrrëgullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemiti, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtima, vërsimet, erozionet, trazirat civile, eksplodimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtëj kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

28.3 Pa marrë parasysh dispozitat e Neneve 14 dhe 26, Furnizuesi nuk do të jetë i detyruar të heqë dorë nga garancia e realizimit, dëmet e likuiduarë ose ndërprerja për shkak të shkeljes nëse, dhe deri në atë masë sa, vonesa e tij e realizimit ose mënyrë tjetër dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Gjithashtu, pa marrë parasysh dispozitat e Neneve 18.4 dhe 27, Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nga Furnizuesi për shkelje të kontratës, nëse dhe deri në atë masë sa vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloji tjetër i dëshimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

28.4 Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrëthanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrëthanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga autoriteti kontraktues me shkrim, Furnizuesi do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përdërisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjete e arsyeshme zbatojë mjete të tillë alternative përvèç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga autoriteti kontraktues.

28.5 Nëse Furnizuesi shkakton kosto plotësuese gjatë zbatimit të urdhreve të autoritetit kontraktues ose gjatë përdorimit të mjetave alternative sipas nenit 28.4 shuma e saj do të certifikohet nga autoriteti kontraktues.

Neni 29 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

29.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekje përfshirë zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim përfshirë qëndrimet e tyre në të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kérkesës përfshirë zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh përfshirë arritur zgjidhje miqësore dështron ose nëse pala dështron të përgjigjet me kohë ndaj kérkesave përfshirë zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

29.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështron, palët mund të merren vesh të përpilen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore përfshirë zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 30 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

30.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore përfshirë zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kérkojë:

a) ose vendim nga gjyqi; ose

b) kurdo qe palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK..

32.2 Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

PJESA III E KONTRATËS KUSHTET E VECANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksoni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha Shqipe .
Siguria e ekzekutimit	8.1	Shuma e sigurisë së ekzekutimit është 10% e vleres se kontrates me vlefshmëri prej 13 muaj
Sigurimi	9.1	Incotermini i aplikueshëm është DDP (Delivery Duty Paid).
Cilësia e furnizimeve	16.2	Autoriteti Kontraktues do te refuzoje çdo dergese te materilait i cili deshton ne permbushjen e specifikimeve minimale te cilesise te percaktuara ne specifikimin teknik.
Inspektimi dhe testimi	17.2	Inspektimi dhe testimi do te kryhen me rastin e dorëzimit dhe ne përpunhje me Nenin 17 te Kushteve te Përgjithshme ne adresat e specifikuara ne Nenin 2.2 te Kontratës.
Parimet përgjithshme të pagesave	18	Kërkesat për pagese do të bëhen për furnizimet e dorëzuara në baza mujore (ex post). Pagesa do të autorizohet dhe do të bëhet nga Autoriteti Kontraktues për furnizimet e dorëzuara ne baza mujore (ex post).

		Nuk ka pagese paraprake.
Dorëzimi	19.3	<p>Furnizuesi do t'i bartë të gjitha rreziqet që kanë të bëjnë me mallrat deri në pranimin në destinacion. Furnizimet duhet të paketohen në mënyrë që të parandalohet dëmtimi i tyre deri në destinacionin e tyre.</p> <p>Dërgesa:</p> <p>Dërgesat do të bëhet brenda 20 ditëve pas marrjes se "urdhër blerjes" nga ana e Furnizuesit.</p> <p>Dorëzimi do të bëhet në një ditë pune dhe gjatë orarit të punës të Autoritetit kontraktues (e hënë - e premte, 8:00-16:00).</p>
Obligimet e garacionit	22.1	<i>I vite</i>
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	29.2	Komisioni per ndermjetsim pranë Ministrise se Drejtësise
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	30.1	<p>a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë ose</p> <p>b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë.</p> <p>Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.</p>

LLOT 2

Furnizim me reagjenta per biokimi - Sasia për 1 vit –

Artikulli	Sasia	Njësie	Cmimi për njësi	Totali me TVSH
1. Reagjentë për glukozë	45	Litra	15.00	675.00
2. Reagjent për Kolesterol	32	Litra	35.00	1120.00
3. Reagjent për triglyceride t	32	Litra	75.00	2400.00
4. Reagjent për Ure kinetike	35	Litra	45.00	1575.00
5. Reagjent për Ure human për fotometër R1	8	Litra	40.00	320.00
6. Reagjent për Ure human për fotometër R2	8	Litra	20.00	160.00
7. Reagjent për Kreatinininin JAFF metod	40	Litra	25.00	1000.00
8. Reagjent për AST(GOT)	20	Litra	50.00	1000.00
9. Reagjent për ALT(AST)	20	Litra	50.00	1000.00
10. Bilirubin totale	12	Litra	30.00	360.00
11. Bilirubin direkte	12	Litra	30.00	360.00
12. Serum kontroll N multiparametrik (1x5ml)	60	Copë	17.00	1020.00
13. Serum kontroll P multiparametirk (1x5ml)	60	Copë	17.00	1020.00
14. Multikalibrator (1x3ml)	10	Copë	15.00	150.00
15. Acid sulfosalicilik 20 %	40	Litra	25.00	1000.00
16. Na-citrat 3.8%	5	Litra	15.00	75.00
17. Jod 1%	5	Litra	15.00	75.00



18. Erlich(reagjet për identifikimin e urobilinogjenit në urine) liter	5	Litra	30.00	150.00
19. Tyrk	1	Litra	50.00	50.00
20. Klinera për Selektra : a) Acid solution	20	Litra	65.00	1300.00
21. Klinera për Selektra : b) System solution	12	Litra	90.00	1080.00
22. Klinera për Selektra : c)System cleaning solution	12	Litra	70.00	840.00
23. Clining deproteizing solution për Keylab dhe Pioway	2	Litra	39.00	78.00
TOTALI me TVSH				16808.00 €

Reagjentët të kenë aplikacione për programimin automatic për aparatet ekzistues Selectra, Keylab, COBASS C111 dhe Pioway, Selectra XS – 1 aparat, Selectra S – 5 aparat, Selectra M – 4 aparat, Keylab – 6 aparat, COBASS C111 – 2 aparat, dhe Pioway – 1 aparat.